



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 369/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.06.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Alen-Co” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Blerje materiale elektrike për Agjensinë e Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan*”, me nr. REF-10462-02-25-2019, me vlerë të pritshme të kontratave 14.999.984 lekë (pa TVSH) dhe fond limit (shumatorja e cimeve për njësi) 128.816 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

Ankimues: Operatori ekonomik “Maliq Haka” p.f.
Adresa: Hotel Skampa, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Elbasan
Adresa: Rr. “Qemal Stafa”, Elbasan.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Alen-Co” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, P. Delta 1, 1001, Tiranë

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 26.02.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Blerje materiale elektrike për Agjensinë e Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan*”, me nr. REF-10462-02-25-2019, me vlerë të pritshme të kontratave 14.999.984 lekë (pa TVSH) dhe fond limit (shumatorja e cimeve për njësi) 128.816 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

II.2 Në datën 26.03.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 12.04.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|----------------------|----------------------------|
| 1. “Alen-Co” sh.p.k. | 69,543 lekë, Kualifikuar; |
| 2. “Maliq Haka” p.f. | 73,755 lekë, Kualifikuar; |
| 3. “Zeqiri” sh.p.k. | 91,715 lekë, Kualifikuar; |
| 4. “Vassa” sh.p.k. | 107,180 lekë, Kualifikuar; |

II.4.Në datën 17.04.2019, operatori ekonomik “Maliq Haka” p.f. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alen-Co” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 3144/1 Prot. datë 23.04.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Maliq Haka” p.f., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.6.Në datën 02.05.2019, operatori ekonomik “Maliq Haka” p.f. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Komisioni i vleresimit te ofertave ka gabuar ne vleresimin e tij ne dy drejtime: 1. KVO ka kualifikuar operatorin ekonomik Alen-Co i cili nuk ploteson kriteret per kualifikim te domosdoshme per tu kualifikuar ne tender. 2. KVO ka kualifikuar operatorin ekonomik Alen-Co pas paraqitjes se dokumentacionit jo te rregullt dhe ligjor per justifikimin e ofertes anomalisht te ulet. Kemi pretenduar se njohur ne sistemin e prokurimeve me kerkesen KVO te Bashkise Elbasan derguar operatorin ekonomike ALEN-CO per shpjegime lidhur me oferten anomalisht ulet per Blerje materiale elektrike per Ashp ,zhvilluar me date 26.03.2019 ku dhe ne si operator kemi marre pjese tender,kemi interesin tone paresor dhe kemi ndjekur ne SPE vazhdimisht korespondencat qe autoriteti kontraktor ka zhvilluar me operatoret dhe jemi njohur kerkesen e KVO drejtuar operatorit ALEN-CO si dhe pergjigjen si me poshte. per pergjigjen e kthyer me date 12.04.2019 ora 12:59 min Nga operatori “ALEN-CO” sh.p.k.

Argumentat qe ka paraqitur operatori Alen-Co nuk qendrojne, pasi jane autorizime te datave te hershme duke filluar 08/07/2015-13/05/2018 ,autorizimet nuk jane referuar objektin e prokurimit Bashkia Elbasan Blerje materiale elektrike per ASHP Elbasan, Po ju japim shpjegimin si me poshte per autorizimet dhe produktet qe jane referuar(fotokopje).

a-Produktet 1,3,5,17,21,75 -Kompania prodhuese Philips kontakte me distributorin Rumun. Eshte paraqitur autorizimi i Leshuar Poëer Elektrik ne Rumani me date 03/05/2018 per operatorin Alen-CO shpk. Ky autorizim eshte leshuar nga Power Elektrik qe operatori te marri pjese ne tenderin ne Autoritetin “Bashkia Shkoder” me objekt “Blerje materiale rehabilituese per mirembajtjen e rrjetit ekzistues te ndricimit publik dhe te godines se Bashkise” Operatori Alen-CO shpk nuk ka paraqitur dokumenta provuese qe mund te provonte qe autorizimi vazhdonte bashkepunimi tregetar (fatura malli ,fatura zhdoganime,oferta te marra cmimeve te rifreskuara per vitin 2019) Pra ky autorizim ka qene i vlefshem vetem per tenderin ne Bashkine Shkoder per vitin 2018 pra vlefshmeria eshte zero. per objektin Bashkine Elbasan per vitin 26.03.2019 ,Pra dhe cmimet ne bursa kane pasur ndryshime te medha. Pra nuk eshte besueshmeria ,dhe garantimi i cmimeve te ofruara per artikujt 1,3,5,17,21,75. Pra argumetat per keto produkte nuk jane te Vlefshme. Dokumenta paraqitura (fotokopje).

b-Produktet 19.20.37-Kompania prodhuese schneider elektrik,kontakte me degen e kompanine ne Bullgari. Eshte paraqitur autorizimi i leshuar schneider elektrik me date 05/04/2018 per operatorin Alen-CO shpk. Ky autorizim eshte leshuar nga schneider elektrik qe operatori te marri pjese ne tenderin ne Autoritetin “Ost SH.A” me objekt “Rinovim i zbarave 20kv ne Tirana 1” Operatori Alen-CO shpk nuk ka paraqitur dokumenta provuese qe mund te provonte qe autorizimi vazhdonte bashkepunimi tregetar (fatura malli ,fatura zhdoganime,oferta te marra cmimeve te rifreskuara per vitin 2019) Pra ky autorizim ka qene i vlefshem vetem ner tenderin Ne Ost SH.A ner vitin 2018 pra

vlefshmeria eshte zero per objektin Bashkine Elbasan per vitin 26.03.2019 ,Pra dhe cmimet ne bursa kane pasur ndryshime te medha. Pra nuk eshte besueshmeria ,dhe garantimi i cmimeve te ofruara per anikujt 19.20.37. Pra argumentat per keto produkte 19.20.37 nuk jane te vlefshme. Dokumenta paraqitura (fotokopje).

c-Produktet 53-62-63-76-77-Kompania prodhuese Suntree,perfaqesues i kesaj kompanie. ME DATE 16/08/2016. Nga autorizimi i paraqitur i prodhuesit ,eshte autorizur Kompania “Fat-Group shpk” e jo Shoqeria Alen-Co shpk. Pra Alen-Co shpk nuk ka paraqitur autorizime per produktet 53-62-63-76-77,Pra argumentat per keto produkte nuk jane te vlefshme. Dokumenta paraqitura (fotokopje).

d-Produldet 78,80 -Kompania prodhuese Nexans,Perfaqesues te kesaj kompanie. Eshte paraqitur autorizimi i leshuar Nexans Group me date 08/07/2015 per operatorin Alen-CO shpk,Prodhues i kabujve elektrike dhe aksesoreve te kabujve. Dokumenta paraqitura (fotokopje). Alen-CO nuk ka paraqitur dokumenta provuese qe mund te provonte qe autorizimi vazhdonte bashkepunimi tregetar (fatura malli ,fatura zhdoganime,oferta te marra cmimeve te rivreskuara per vitin 2019) per objektin Bashkine Elbasan Per vitin 26.03.2019 ,Pra dhe cmimet ne bursa kane pasur ndryshime te medha sidomos per metalet me ngjyre bakri(kabujt) diferenca 30% ndryshim cmimi me i larte. Pra nuk eshte besueshmeria ,dhe garantimi i cmimeve te ofruara per artikujt 78,80. Pra argumentat per keto produkte nuk jane te vlefshme vetem me nje autorizim ne date 08/07/2015 para 4 vitesh.me dokumenta fotokopje.

e-Produktet 40,43,46 -LDT distributor i kesaj kompanie ne Shqiperi Etj.Ldt prodhues materialeve elektrike ,kokave ndricuesve dhe prokateve te galvinizuara te togezimit ,ALEN-CO ESHTE AUTORIZUAR SHPERDAJE PRODUKTET ,SIPAS OFERTES nr.243 me date 08/03/2017 dhe jo i autorizuar lidhi kontrata ne emer ltd,dhe eshte e VLEFSHME me detajet e ofertes nr.243 date 08/03/2017. Alen-CO nuk ka paraqitur dokumenta provuese qe mund te provonte qe autorizimi vazhdonte bashkepunimi tregetar (fatura malli ,fatura zhdoganime,oferta te marra cmimeve te rifreskuara per vitin 2019) per objektin Bashkine Elbasan Per vitin 26.03.2019 ,Pra dhe cmimet ne bursa kane pasur ndryshime te medha sidomos per metalet me ngjyre diferenca 30% ndryshim cmimi me i larte. Pra nuk eshte besueshmeria ,dhe garantimi i cmimeve te ofruara per artikujt 40,43,46. Pra argumentat per keto produkte nuk jane te vlefshme vetem me nje autorizim ne date 08/03/2017 para 2 vitesh.me dokumenta fotokopje.

Si perfundim sipas nenit 56 nuk ka plotesuar asnje nga kater kushtet kumulative qe justifikojne oferten anomalisht te ulet.

a.informacion shites lidhur me argumentimin dhe analizën e kosos për artikujt

b.Faturë tatimore shitjeje

c.Faturë tatimore Blerje

d.Faturë zhdoganimi

e.një përshkrim analitik të metodës së ndërtimit të ofertës ekonomike

f.informacion të detajuar lidhur me analizimin e kosos për zërat/elementët e veçantë të ofertës, Paraqitja e faturave tatimore të shitjes të shoqëruara me analizën e kosos për të gjithë zërat element të preventivit.,punëtori, transport apo shpenzime të tjera

Pra ky operator duhet te ishte skualifikuar nga KVO pasi nuk ploteson asnje nga kater kushtet kumulative sipas nenit 56 te LPP Ne lidhje me dokumentacionit e dorezuar SPE shpjegim oferte anomalisht ulet me date 12.04.2019 te cilat jane fotokopje kemi dyshime se vertetimi i leshuar nga noteri nuk eshte i sakte ,se nuk eshte origjinal. a-Data me shkrim dore 11/04/2019 ka shenje ke numri 4 dhe me shkrim mbrapa ne kllapa nuk permban daten por vetem vitin. b-Po te krahasojme shkrimin me numrin e protokollimit me daten eshte i ndryshem. c-Ne vertetim nuk jane paraqitur

lista dokumentave noterizimit,data e perkthimit nuk perputhet me vertetimin e leshuar nga noteri. Si perfundim i gjithë dokumentacioni nuk ka vule origjinale te noterit. Si rrjedhim i ketyreve fakteve , mendojme dhe kemi dyshime se edhe dokumentacioni paraqitur ne tender nuk mund te jene te sakta si me poshte.

Duke u bazuar në DST-në e tenderit, në pikën 2 “kriteret e vecanta për kualifikim” në paragrafin 2.3 të kapacitetit teknik , numër 2, ju keni kërkuar Ofertuesi duhet të dorëzojë Katallogje dhe/ose Skeda Teknike të cilat të përmbajnë specifikimet teknike për pjesët elektrike, Lidhur me këtë kërkesë, shoqëria jonë dyshon së operatori Alen-CO shpk,nuk i ka paraqitur katalogjet per cdo produkt ne perputhje me specifikimeve teknike të mostrave te paraqitura ne piken 6 të dst., Prandaj kërkojmë nga institucioni juaj që të rishqyrtoni të gjithë dokumentacionin teknik te paraqitur nga ky operator. Ne lidhje me piken 4 Mallrat objekt prokurimi, kërkohet të jenë të Çertifikuara sipas standartit ndërkombëtar CE, për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatat e cilësisë. Shoqëria jonë edhe për këtë kërkesë kemi dyshime se Operatori Alen-Co shpk ,Nuk i ka paraqitur te gjitha certifikat Ce . Ne lidhje me kete pike -2.3 Kapaciteti teknik: 1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 5'999'994 (pesemilion e nenteqind e nentedhjetë e nentemijë e nenteqind e nentedhjetë e kater) lekë pa tvsh, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Dhe per kete pike kriteri kemi dyshime se nuk eshte plotesuar nga operatori ekonomik Alen-Co,duke marrur shkas nga pergjigja e sjelle nga Bashkia Elbasan , ku cilesohet se ky operator ka realizuar kontrate ngjashme per te njejtin mallra me objekt prokurimi per Bashkine Elbasan. Gjithashtu theksojme se kontrata e meparshme nuk eshte per te njejtat mallra pasi ato ndryshojne ne 90% te tyre....

....Ne cilin rast lind pyetja dhe cfare elemente te vecante te ofertes ofertuesi ka arritur te argumentojte dhe te dokumentojte me prova shkresore sqarimet per elementin/elementet e vecanta të ofertës. Ju rikujtojme se Alen-Co ne sqarimin e tij per KVO ka paraqitur vetem autorizime dhe ato te dyshimta nga ana e tyre por qe ne asnje rast nuk ka nje vlere ekonomike qe percakton nje kosto te njerit ze malli apo tjetrit. Bashkia Elbasan ka pretenduar ne pergjigjen e saj ka pretenduar se: Vlen te theksohet se Operatori Ekonomik “Alen-Co ” sh.p.k. ka realizuar kontrata te meparshme te suksesshme me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Elbasan, per te njejtin objekt prokurimi. Ju informojme se nje document i tille nuk eshte paraqitur si justifikim nga Alen Co ne sqarimet e tij per oferten anomalisht te ulet dhe gjithashtu theksojme se kontrata e meparshme nuk eshte per te njejtat mallra pasi ato ndryshojne ne 90% te tyre ne kundershtim me percaktimet e nenit 56 te LPP.

Nga dokumentat qe jane paraqitur ne sistem nga operatori Alen-Co per shpjegimin e ofertes anomalisht ulet konstatohet se i gjithë dokumentacioni jane fotokopje ,duke perfshire edhe nenshkrimin e vulen e noterit. Pra kemi mos argumentim te ofertes anomalisht te ulet nga ana e Alen Co sh.p.k. ne kundershtim me percaktimet e nenit 56 te LPP si dhe paraqitje dokumentacioni thellesit te pretenduara si te modifikuara persa kohe qe AK nuk ka verifikuara apo bere kerkese per paraqitjen e tyre ne origjinal nga ana e OE por dhe noteri perkates. [...]

II.7.Në datën 06.05.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.3543prot., datë 03.05.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Maliq Haka” p.f. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alen-Co” sh.p.k. me argumentin: “[...]KVO ka kualifikuar operatorin ekonomik Alen-Co pas paraqitjes se dokumentacionit jo te rregullt dhe ligjor per justifikimin e ofertes anomalisht te ulet.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se: “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...].”

III.1.3. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht

të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga LPP, janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi i normës së mësipërme lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën ekonomike të operatorit ekonomik “Alen-Co” sh.p.k. dhe nga ky verifikim rezulton se, nga ana e këtij operatori është paraqitur oferta ekonomike, plotësuar sipas zërave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, referuar bazës ligjore si më sipër cituar (shiko pika III.1.2.), rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Alen-Co” sh.p.k. është anomalisht e ulët dhe sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe ka kërkuar që nga operatori ekonomik të paraqitej argumentimi i vlerës të ofruar, me anë të sistemit elektronik të prokurimeve.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se, nga ana e operatorit ekonomik “Alen-Co” sh.p.k., me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është dorëzuar në mënyrë elektronike në SPE shkresë me anë të së cilës sqaron ofertën e paraqitur, si dhe ka bashkëlidhur dokumentat, si më poshtë vijon:

1. Autorizim distributori datë 05.03.2018, lëshuar nga “Power Electric srl”, për operatorin ekonomik “Alen-Co” sh.p.k.
2. Certifikatë distribucioni lëshuar nga “Philips” për kompaninë “Power Electric srl”.
3. Certifikatë partneriteti lëshuar nga “Philips” për kompaninë “Power Electric srl”.
4. Autorizim prodhuesi datë 16.08.2016, lëshuar nga “Xinchi Electric co. ltd”, për operatorin ekonomik “Fat-Group” sh.p.k.
5. Autorizim prodhuesi datë 05.04.2018, lëshuar nga “Schneider Electric Bulgaria”, për operatorin ekonomik “Alen-Co” sh.p.k.
6. Autorizim prodhuesi datë 08.07.2015, lëshuar nga “Nexans Romania srl”, për operatorin ekonomik “Alen-Co” sh.p.k.
7. Autorizim prodhuesi datë 13.03.2017, lëshuar nga “LDT”, për operatorin ekonomik “Alen-Co” sh.p.k.

III.1.6. Nga verifikimi i bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik rezulton se me anë të shkresës dërguar autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “Alen-Co” sh.p.k. ka bërë në mënyrë deklarative argumentimet përkatëse mbi koston e cmimeve të ofruara për produktet e objekt prokurimi, si dhe e ka shoqëruar me dokumenta të cilat nuk mund të konsiderohen si dokumentacion provues në kuptim të ligjit, për të mbështetur argumentimin e ofertës së tij, pasi këto autorizime prodhuesi/distributori nuk janë për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe nuk pasqyrojnë cmime apo elementë favorizues për operatorin ekonomik “Alen-Co” sh.p.k., për të mbështetur ofertën e tij, në këtë procedurë prokurimi.

Referuar nenit 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, KPP gjykon se operatori ekonomik “Alen-Co” sh.p.k. ka patur detyrimin që analizën e cmimeve të dërguar pranë autoritetit kontraktor, ta shoqërojë me dokumenta provues fatura blerje, fletë zhdoganimi ose cdo dokument tjetër provues të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik. KPP riktheson se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, i cili duhet të jap analiza sa më të sakta dhe të shoqëruara me dokumenta provuese për të bindur se oferta e paraqitur prej tij nuk është e papërgjegjshme. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Alen-Co” sh.p.k. oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime të cilat nuk provohen me dokumentacionin sipas përcaktimeve ligjore, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme, pasi mbeten në kuadrin deklarativ. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Alen-Co” sh.p.k. nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje të plotë me nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ndaj oferta e këtij operatori ekonomik duhet skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Maliq Haka” p.f. qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Maliq Haka” p.f. për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Alen-Co” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të

këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Maliq Haka” p.f., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Blerje materiale elektrike për Agjensinë e Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan*”, me nr. REF-10462-02-25-2019, me vlerë të pritshme të kontratave 14.999.984 lekë (pa TVSH) dhe fond limit (shumatorja e cimeve për njësi) 128.816 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Alen-Co” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Maliq Haka” p.f.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 792 protokoli Datë 02.05.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha